



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

q&Wdq0LHvk370Iu#k2sQ2TigNumri 2023:107342

i lëndës:

Datë: 23.11.2023

Numri i dokumentit: 04966002

PKR.nr.64/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për krime të rënda, me Kryetaren e trupit gjykues Violeta Husaj Rugova, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Besa Dervishaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarës A.B.nga S., rruga “E. K.”, p. ..., për veprë penale, “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267 par.2 e lidhur me nenin 275 par.1 nën par. 1.8 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda PP/I.nr.50/2023 të datës 22.06.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prezencë të Prokurores së shtetit Lumturije Vuçetaj, të akuzuarës A.B.dhe mbrojtësit së saj sipas detyrës zyrtare av. Osman Lajçi nga Peja, me datë 20.11.2023 mori dhe shpalli, si dhe me datë 23.11.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara:

A.B.nga babai S. dhe nënës K. e gjinisë S., e lindur me datë në P. me vendbanim në rrugën “E. K.” p. ... K. S., ka të kryer nëntë vite të shkollës fillore, e martuar, e pa punë, e gjendjes së dobët ekonomik, e identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr., Shqiptare, Shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORE

Për shkak se:

Më datë 25.04.2023, rreth orës 10:15, në Qendrën Korrektuese në Dubravë, Komuna Istog, brenda institucionit korrektues, pa autorizim posedon substanca të shpallura me ligj si narkotikë me qëllim të shpërndarjes, në atë mënyrë që, e pandehura ditën kritike kishte shkuar për vizitë tek bashkëshorti i saj P. B. i cili gjendej në vuajtje të dënimit pranë këtij Institucioni korrektues dhe e njëjta përderisa ndodhej duke kryer procedurat e kontrollit për të hyrë në sallën e vizitorëve, ku pas kërkesës së zyrtarëve korrektues që e njëjta të hapte gojën për kontroll, e pandehura menjëherë gëlltit sasinë e substancës narkotike të llojit “Marihuanë”, e cila kishte qenë e mbështjell me qese plasmasi, në peshë neto prej gram, ku me ta vërejtur këtë gjë oficerët korrektues, kanë njoftuar policinë dhe më pas e pandehura është dërguar për kontroll

mjekësore pranë Spitalit Rajonal në Pejë dhe SHSKUK në Prishtinë, ku pas ekzaminimeve dhe sigurimit të shëndetit të të njëjtës, substanca narkotike sigurohet dhe sekuestrohet nga jashtëqitja e saj.

-me çka ka kryer vepër penale, “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 275 par.1 nën par. 1.8 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e neneve 7, 17, 21 par. 2, 38, 39, 40, 42,43, 69, 70,71,72, të KPRK-së, neni 267 par.2 lidhur me nenin 275 par.1 nën par. 1.8 të KPRK-së, nenin 364 të KPPRK-së, të akuzuaren e:

G J Y K O N

Të akuzuarës i caktohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti dhe dënim me gjobë në shumë prej 150€ (njëqind e pesëdhjetë euro), të cilat dënime do të ekzekutohen më së largu në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Në qoftë se e akuzuara nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë në afat të caktuar, atëherë i njëjti dënim do të zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 (njëzet) euro të gjobës.

Të akuzuarës i konfiskohen:

-Substanca narkotike e llojit Kanabis (Marihuanë) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC) në peshë neto gram sipas rastit policor dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit e njëjta do të shkatërrohet dhe

-Një telefon mobil i llojit “IPHONE-6”, ngjyrë e bardhë me SIM kartelë “Ipko”, me numër telefoni .../...-... dhe me IMEI, me këtë telefon do të administroj Agjencioni për administrimin e pasurisë së sekuestruar apo konfiskuar do ta likujdoj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi më së largu në afat prej 10 ditësh.

E akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 15€ (pesëmbëdhjetë euro), si dhe në emër të kompozimit të viktimave të krimit shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro). Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda, ka ngrit aktakuzë PP/I.nr.50/2023 të datës 22.06.2023, ndaj të akuzuarës A.B.nga S., rruga “E. K.”, p. ..., për vepër penale, “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267 par.2 e lidhur me nenin 275 par.1 nën par. 1.8 të KPRK-së,

Gjykata ka caktuar mbajtën e shqyrtimit fillestar me datë 20.11.2023 Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurores së shtetit PP/I.nr.50/2023 të datës 22.06.2023, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se e akuzuara e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarës i ka dhënë mundësinë që të deklarohen për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarën për rendësin dhe pasojat e pranimi të fajësisë dhe e akuzuara A.B.pas konsultimit me mbrojtësin e saj ka deklaruar se i ka të qartat pasojat e përparësisë e pranimi të fajësisë deklaruar se: e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Prokurorja e shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë, meqenëse pranimi është i bazuar dhe i provuar edhe në provat të cilat janë bashkangjitur aktakuzës, dhe e ka pranuar në të gjitha fazat e procedurës, pajtohet me pranimin e fajësisë ashtu që i propozon gjykatës që ta aprovoi.

Mbrojtësi i të akuzuarës A.B. av. Osman Lajçi deklaruar: se pajtohem me pranimin e fajësisë dhe është bërë në konsultim me mua dhe unë si mbrojtës jam bindur se pranimi i fajësisë është në favor të mbrojturës time.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 248 të KPPRK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 241 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata erdhi në përfundim se në veprimet e të akuzuarës ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi bazuar në pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës, si dhe duke pasur parasysh provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: raporti i oficerit H. N. #... i datës 26.04.2023, raporti ndaj vizitorit i përpiluar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, gjegjësisht zyrtari korrektues i datës 25.04.2023, deklarata e të pandehurës A.B.e dhënë pranë stacionit policor me dt. 25.04.2023, deklarata e dhënë me shkrim dore e dt. 25.04.2023 si dhe deklarata e dhënë në prokurori me dt. 17.05.2023, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 25.04.2023, deklarata e dëshmitarit S. B. e dhënë pranë stacionit policor me datë 25.04.2023, deklarata e dëshmitarit P. B. e dhënë pranë Qendrës Korrektuese në Dubravë me dt. 10.05.2023, deklarata e dëshmitares H. B. e dhënë pranë stacionit policor me dt. 11.05.2023, si dhe deklarata e dhënë në prokurori me dt. 17.05.2023, fotodokumentacioni, raporti mjekësor në emër të dyshuarës A.B.me nr. i datës 25.04.2023 i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë-Emergjencia, raporti mjekësor në emër të dyshuarës A.B.me nr. i datës 25.04.2023 i lëshuar nga SHSKUK-Klinika Emergjente në Prishtinë dhe Klinika e Gastroenterologjisë dhe Hepatologji, CD-ja me video-inqizimet nga Kamerate e sigurisë së Qendrës Korrektuese në Dubravë si dhe Raporti i ekspertimit për ekzaminimin të substancës narkotike me nr. reference; .../....-..../..-.... i datës 05.06.2023, i parashtruar nga AKF-ja. Andaj gjykata e shpalli fajtor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me rrethanat për dënimin të gjitha palët janë deklaruar se nuk është e nevojshme të caktohet seancë e veçantë dhe janë të gatshëm të deklarohen në seancë fillestare.

Prokurorja e shtetit ka deklaruar lidhur me rrethanat për dënimin se meqenëse e akuzuara e pranoi fajësinë, për veprën penale për të cilën është akuzuar, i propozon Gjykatës që të njëjtën ta shpall fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit dhe ta obligoi në pagesën e shpenzimeve të procedurës penale, po ashtu mbetet pranë propozimit për konfiskim të konstatuara në aktakuzë në faqe nr.4 pika VII, si dhe sa i përket rrethanave mbes pranë rrethanave lehtësuese dhe rënduese të konstatuara në pikën V dhe VI në faqe nr.4 të aktakuzës.

Mbrojtësi i të akuzuarës lidhur me rrethanat për dënimin i ka propozuar Gjykatës që me rastin e caktimit të dënimit të merr parasysh si rrethana lehtësuese pranimin e fajësisë që është i vullnetshëm dhe e ka pranuar në të gjitha fazat e procedurës, e pandehura është për herë të parë dhe nuk ka qenë e dënuar, i propozoj Gjykatës si provë raportin specilaistik e cila është e sëmur me epilepsi e cila shkon në kontrolle mjekësore çdo 6 muaj dhe për këtë ia dorëzoi raportet mjekësore që nga viti 2016 e deri më tani, prandaj propozon Gjykatës që të njëjtës ti shqiptoj dënim të kushtëzuar me anë të së cilës do të arrihet qëllimi i dënimit, e njëjta është penduar dhe nuk do të kryej më veprë penale, është e moshës së re,

E akuzuara A.B.ka deklaruar se e përkrah fjalën e mbrojtësit, nuk do ti përsëris veprat penale kërkon nga Gjykata që t'ia lehtësoi dënimin.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit dhe nga rrethanat lehtësuese gjeti se e kanë pranuar fajësinë qysh në fillim, është penduar dhe ka premtuar se nuk do të përsëris veprën penale, për gjykatën nuk ka të dhëna se e njëjta më parë ka ra ndesh me ligjin, dhe gjendjen e saj shëndetësore që rezulton nga dokumentacioni mjekësorë. Nga rrethanat rënduese mori parasysh shkallen e lartë të dënisë dhe dashjes gjë që rezulton nga veprimet e të akuzuarës të ditës kritike, ku e njëjta pasi që shkon për vizitë te bashkëshorti i saj i cili gjendej në vuajtje të dënimit në burgun e Dubravës, kur e njëjta ishte duke u kontrolluar nga zyrtaret e burgut-gardianet dhe pasi që ata dyshojnë se ka diçka në gojë kërkojnë nga e akuzuara që të hap gojën, mirëpo ajo gëlltit substancën narkotike, duke e rrezikuar edhe shëndetin e vet, për çka është dashur edhe ndihma mjekësore në Spitalit Rajonal në Pejë dhe pastaj edhe SHSKUK në Prishtinë.

Gjykata bazuar në pranimin e fajësisë dhe pendimin e shprehur nga e njëjta para gjykatës të cilat i mori si rrethana veçanërisht lehtësuese bazuar në dispozitën e nenit 71 dhe 72 të KPRK-së, të akuzuarës i zbut dënimin duke i caktuar dënimin me burg nën kufirin e paraparë me dispozitën e nenit 275 par. 1 nën par. 1.8 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarën e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarës në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Konform nenit 275 par. 2 dhe 267 par.5 të KPRK-së konfiskohet substanca narkotike e llojit Kanabis (Marihuanë) e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimit e njëjta do të shkatërrohet, si objekt i kryerjes së veprës penale .

Konform nenit 270 të KPRK-së konfiskohet telefoni me sim-kartel si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, si mjet i cili ka shërbyer në kryerjen e veprës penale. Konform nenit 277 e urdhëroj likuidimin e telefonit nga Agjensioni për administrimin e pasurisë së sekuestruar apo konfiskuar.

Duke u bazuar në nenin 450 të KPRK-së, e obligoi të akuzuarën në paguarjen e paushallit gjyqësor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit e obligoi të akuzuarën në paguarjen e taksës për viktimat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 364 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA ,**

2023:107342, 23.11.2023

Kryetarja e trupit gjykues

Violeta Husaj Rugova

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.